



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 211, Datë 23.12.2011**

**“Për**

**hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |   |         |             |         |
|---|---------|-------------|---------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Servete | GRUDA       | Anëtar  |
| • | Koço    | BROKA       | Anëtar  |
| • | Rezana  | KONOMI      | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 23.12.2011, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Hapja e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

**Baza ligjore:** Nenet 24, shkronja d); 26; 28, shkronja b); neni 4, pika 1; dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k”;

## **VËREN SE:**

1. Sipas të dhënave paraprake të marra nga Autoriteti i Konkurrencës rezulton se shoqëritë e Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k”; kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, ku ndërmarrjet konkurrojnë me të njëjtat kapacitete. Kështu p.sh: duke i dhënë zyra me qera, automjete me qera njera-tjetrës; duke mbuluar shërbimet nga salla operative të njëjta etj.
2. Nga të dhënat paraprake rezulton se në shumicën e tenderave që futen shoqëritë e mësipërme duke mbështetur njëra-tjetrën janë fitues njëra nga këto shoqëri.
3. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto shenja tregojnë për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

## **V E N D O S I:**

- I. Të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k (“Ire-zan”), për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Periudha e hetimit do të jete 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2011.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 31.03.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete Gruda**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Rezana Konomi**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R**